

# UDHËZIMI PEJGAMBERIK

për t'i bërë ballë virusit epidemik



Përgatiti  
Agron Krasniqi

---

# **UDHËZIMI PEJGAMBERIK**

## **për t'i bërë ballë virusit epidemik**

**Përgatiti**  
**Agron Krasniqi**

---

---

## **Udhëzimi pejgamberik për t'i bërë ballë virusit epidemik**

Falënderimi dhe lavdërimi i takojnë Allahut të Lartësuar, Zotit të botëve, Krijuesit të gjithçkaje, në dorën e të Cilit është çdo gjë. Vetëm Atij i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës dhe tek Ai kthehet çdo gjë. Ai është i Gjithëdijshtëm për çdo send.

Paqja dhe lavdërimi i Tij qofshin për Muhamedin, të Dërguarin e Tij të fundit.

Thuajse të gjithë njerëzit në botë sot janë të angazhuar me atë se çfarë është duke ndodhur me epideminë (pandeminë) e shfaqur, gjegjësisht koronavirusin. Kjo tashmë është bërë një realitet që është duke e përjetuar çdonjëri prej nesh, varësisht nga gjendja e tij psikologjike e shpirtërore, qoftë në aspektin e frikës që ndoshta te disa ka kaluar në panik, e qoftë në aspektin se si të përballet me këtë lloj krize e ta tejkalojë atë.

Çdokush që ndjek situatën e krijuar tani, e gjen se njerëzit më së shumti kanë nevojë për mbështetje morale, respektivisht vetëdijesim fetar, të bazuar në besim të pastër në Zotin e Gjithësisë, ngase vetëm kësioj mund të mirëkuptohen ndodhitë, fatkeqësitë dhe sprovat e ndryshme në këtë botë, e që prej tyre pa dyshim është edhe koronavirusi, Allahu na ruajttë prej tij!

Prandaj, duke u nisur nga kjo ndjeva përgjegjësinë për të kujtuar së pari vetën time pastaj dhe besimtarët me disa pika të rëndësishme bazuar në frymën e Kuranit dhe haditheve profetike, andaj them duke u mbështetur në Allahun Fuqiplotë:

---

---

***1. Dije, Allahu të mëshiroftë, se nga bazat e besimit islam është edhe besimi në kader, gjegjësisht në përcaktim të Allahut, ku çdo gjë që ekziston në këtë botë është me caktimin e Allahut, asgjë nuk mund të dal jasht dijes dhe pushtetit të Tij.***

Këtë Allahu i Lartësuar e thekson në shumë vende në Kuran, siç thotë: **"Ai krijoi çdo gjë, duke e përcaktuar atë në mënyrë të qartë e të matur".** (Furkan, 2)

Dhe thotë: **"Vërtet, Ne çdo gjë e kemi krijuar me masë të paracaktuar".** (Kamer, 49)

Komentuesi i Kuranit, Ibn Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të) thotë: **"Allahu krijoi të gjitha krijesat me paracaktim, krijoi për ta të mirën dhe të keqën me paracaktim".**

Gjithashtu, Allahu i Lartësuar thotë: **"E ata jobesimtarët thonë: "Nuk do të na vijë Ora (e Kiametit)"!**

**Thuaju: "Po, për Zotin tim! Me siguri që ajo do t'ju vijë"!**

**Ai i di të gjitha të fshehtat.**

**Atij nuk mund t'i fshihet asnjë grimë as në qiej, as në Tokë, e nuk ka diçka më e vogël apo më e madhe se ajo (grimë), vetëm se është e shënuar në Librin e qartë".** (Seb'e, 3)

Ndërsa, në tekst të saktë profetik, i Dërguari i Allahut ﷺ thotë:

**"Allahu i Lartësuar ka shkruar ndodhitë e të gjitha krijesave pesëdhjetë mijë vjet para se të krijojë qiejt dhe tokën".** Muslimi (2653)

---

## ***2. Beso se sëmundja çfarëdo qoftë ajo është prej Allahut, sikurse edhe shërimi që është në dorën e Tij.***

Në Kuran shkruan: "**Ai është i Cili, kur sëmurem, më shëron**". (Shuara, 80)

Po ashtu, Allahu i Lartësuar thotë: "**Nëse Allahu të godet me ndonjë të keqe, s'ka kush që ta largojë atë përveç Tij, e nëse të dhuron ndonjë të mirë, dije se Ai është i Gjithëfuqishëm për çdo gjë**". (En'am, 17)

Në hadith të saktë i Dërguari i Allahut ﷺ thotë: "**Vërtet, Allahu nuk ka zbritur ndonjë sëmundje vetëm se ka zbritur për të ilaçin**". Buhariu (5678)

## ***3. Jeta dhe vdekja janë në dorë të Allahut Fuqiplotë, çdonjëri e ka afatin e caktuar, askush nuk mund ta ndryshojë atë.***

Allahu i Lartësuar thotë në Kuran: "**Çdo popull ka afatin e vet. Kur t'u vijë afati i tyre, ata nuk mund ta shtyjnë, qoftë edhe për një çast dhe as nuk mund ta shpejtojnë**". (A'raf, 34)

Në hadithin e njohur profetik, i Dërguari i Allahut ﷺ përshkruan fazat e krijimit të njeriut në mitrën e nënës, e që pas 120 ditësh, Allahu i Lartësuar e dërgon një melek, për t'ia dhënë shpirtin foshnjës si dhe e urdhëron atë për katër gjëra: "**të shkruajë rriskun (furnizimin) e tij, jetën e tij (sesa do të jetojë), punën dhe se a do të jetë fatzi opo i lumtur (në botën e tjetër)**".

---

Pra, secili prej nesh ka afatin e caktuar, nuk mund ta përshpejtojë atë asgjë, as koronavirusi, as diçka tjetër.

***4. Ji i bindur se: "ajo (sprovë) që të ka goditur nuk ka mundur të të mos godiste, dhe ajo që nuk të ka goditur nuk ka mundur të të godasë".***

Kjo është gjithashtu pjesë e besimit në kader e, kush e beson këtë e gjen ëmbëlsinë e besimit, i lehtësohen sprovat, i forcohet besimi dhe i zmadhohet njësimi i Zotit (teuhidi).

Shoku i të Dërguarit të Allahut, Ubade ibn Samit i tha të birit të tij:  
*"O biri im! Vërtet, ti nuk do të gjesh ëmbëlsinë e besimit derisa të besosh se ajo që të ka goditur nuk ka mundur të të mos godiste, dhe ajo që nuk të ka goditur, nuk ka mundur të të godasë, kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ duke thënë:*

***"Gjëja e parë të cilën e ka krijuar Allahu është lapsi, të cilit i tha: Shkruaj! Lapsi i tha: Çfarë të shkruaj? Allahu i tha: "Shkruaj çdo gjë që do të ndodhë deri në momentin kur të vijë Ora (e Kiametit)!"***

Ubade vazhdoi e tha: *"O biri im! Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ duke thënë: "Kush vdesë duke mos qenë në këtë besim, nuk më përket mua". Ebu Davudi (4700), hadithi është i saktë.*

Gjithashtu në një tekst tjetër, i Dërguari i Allahut ﷺ i tha Abdullah ibn Abasit:

***"O djalosh! Unë do t'i mësoj disa fjalë: "Ruaje Allahun (duke zbatuar urdhërat dhe ndalesat e Tij), Ai të ruan ty, ruaje Allahun do ta gjesh pranë! Kur të lypësh, lyp prej Allahut, e kur të kërkosh ndihmë, kërko nga Allahu!"***

---

---

***Dhe dije se: po që se të gjithë njerëzit mblidhen për të të bërë mirë, nuk do të mund të të bëjnë mirë përveç asaj që ta ka caktuar Allahu; dhe e kundërta: nëse të gjithë njerëzit bashkohen për të të bërë ndonjë dëm, nuk do të mund të të dëmtojnë përveç asaj që ta ka caktuar Allahu. Tashmë janë ngritur lapsat dhe janë tharë fletët!''.***  
Hadithi është i saktë.

Ky hadith profetik mbjell në zemrën e besimtarit qetësi, siguri dhe rehati, ashtu që gjithë çështjen e tij ia dorëzon Allahut, i lë anash paragjykimet dhe nuk ngjallë panik.

### ***5. Mbështetja në Allahun Fuqiplotë është rrugëdalje nga çdo sprovë.***

Allahu i Lartësuar thotë në Kuran: **"E kushdo që mbështetet tek Allahu, Ai i mjafton atij".** (Talak, 3)

Dhe thotë: **"Thuaj: Nuk do të na godasë vetëm se ajo që na ka caktuar Allahu; Ai është Mbrojtësi ynë dhe vetëm tek Allahu le të mbështeten besimtarët!"**. (Teube, 51)

Dhe thotë: **"E kush do që beson në Allahun, Ai ia udhëzon zemrën atij".** (Tegabun, 11)

Imam Alkame thotë: *"Është për qëllim ai njeri të cilin e godet një fatkeqësi dhe e di se ajo është prej Allahut dhe i nënshtrohet caktimit të Tij"*. Dhe si rezultat Allahu ia udhëzon zemrën atij.

### ***6. Kuptimi i sprovës në këtë botë.***

Allahu i Lartësuar solli njeriun në këtë botë për ta sprovuar atë. Siç thotë në Kuran: **"Ai ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t'ju provuar se**

---

---

kush prej jush do të veprojë më mirë; Ai është i Plotfuqishmi dhe Falësi i Madh". (Mulk, 2)

Pra, Allahu i Lartësuar e sprovon kë të dojë me çka të dojë, me të mira apo të këqija. Ai në Kuran thotë: **"Çdo njeri do ta shijojë vdekjen! Ne ju vëmë në sprovë me të keqe dhe me të mirë dhe te Ne do të ktheheni"**. (Enbija, 35)

Çdo sprovë që e godet besimtarin, ajo është fshirje e mëkateve dhe ngritje e gradave për të, qoftë ajo sprovë e madhe apo e vogël, qoftë edhe një ferrë (gjemb) që mund t'i hyjë në këmbë, apo edhe më pak se ajo.

I Dërguari ﷺ ka thënë: ***"Nuk e godet besimtarin ndonjë ferrë apo diç më e madhe se ajo, vetëm se me të Allahu i Lartësuar do ta ngre atë për një shkallë dhe do t'ia fshijë me të një të keqe (mëkat)"***.

Buhariu (5640) dhe Muslimi (2572).

Gjithashtu, i Dërguari ﷺ thotë: ***"Nuk ka ndonjë musliman që e godet atë një e keqe, qoftë një ferrë në këmbë, a diç më shumë se ajo, vetëm se Allahu do t'ia fshijë me të mëkatet e tij, ashtu siç i bien pemës gjethet e saj"***.

Madje edhe vuajtjet shpirtërore, si: brenga, mërzia, shqetësimi, pikëllimi e të ngjashme, që mund ta godasin besimtarin, janë fshirje e mëkateve për të.

I Dërguari ﷺ ka thënë: ***"Nuk ka diçka që e godet besimtarin, as ndonjë lodhje, as sëmundje e vazhdueshme, as ndonjë brengë, as pikëllim, as ndonjë e keqe, as dëshpërim, qoftë edhe ferra që i hyn në këmbë, vetëm se Allahu do t'ia fshijë me to mëkatet e tij"***.

Buhariu (5642) dhe Muslimi (2573).

---

---

Kështu, vazhdon besimtari të sprovohet në këtë jetë, derisa t'i fshihen atij të gjitha gjynahet me lejen e Allahut.

Pra, çdo sprovë për besimtarin ka dy mirësi:

**E para:** fshirja e mëkateve.

**E dyta:** ngritja e gradave tek Allahu.

## ***7. Pendimi i singertë tek Allahu.***

Duhet ditur se çdo fatkeqësi që e godet njeriun është pasojë e mëkateve të tij, Allahu i Lartësuar thotë në Kuran: "**Çfarëdo fatkeqësie që ju godet, është si pasojë e asaj që keni bërë vetë; megjithatë, Ai fal shumë**". (Shura, 30)

Prandaj, është obligim për secilin prej nesh të pendohet, siç thotë i Lartësuari në Kuran: "**Pendohuni të gjithë tek Allahu, o besimtarë, në mënyrë që të arrini shpëtimin**". (Nur, 31)

Dhe thotë: "**Përse ata nuk kthehen me pendesë tek Allahu e t'i kërkojnë falje Atij?! Kur dihet se Allahu është Falës, Mëshirëplotë!**" (Maideh, 74)

## ***8. Kërkimi falje nga Allahu (Istigfari).***

Nga shkaqet më të mëdha për ruajtje nga dënimi i Allahut është të kërkoshe falje prej Tij. I Lartësuari thotë në Kuran:

**"Allahu nuk do t'i ndëshkojë ata, përderisa ata i kërkojnë falje Atij (istigfar)".** (Enfal, 33)

---

---

**9. Sëmundjet epidemike të cilat shkaktajnë vdekje masive, si: murtaja, kolera e të ngjashme, janë mëshirë për besimtarët, dënim për jobesimtarët.**

I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **"Murtaja është dënim që u është dërguar një grupi nga beni israilët apo disa popujve para jush.."**.  
Buhariu (3473)

Nëna e besimtarëve, Aisheja (Allahu qoftë i kënaqur me të) thotë:  
**"E pyeta të Dërguarin e Allahut ﷺ për murtajën dhe më tregoi se ajo është dënim që Allahu e dërgon ndaj kujt të dojë dhe se Allahu e ka bërë atë mëshirë për besimtarët.."**. Buhariu (3474)

Dijetari i shquar Ibn Uthejmini (Allahu e mëshiroftë) thotë:  
**"I Dërguari i Allahut ﷺ na ka njoftuar se murtaja është dënim që Allahu i Lartësuar ia dërgon kujt të dojë nga robërit e Tij. Ndërsa, murtaja thuhet se: është për qëllim epidemi e caktuar, dhe thuhet se: përfshin çdo lloj epidemie gjithëpërfshirëse që kaplon një vend duke i goditur banorët e tij dhe që vdesin prej saj, varësisht se a është e caktuar, apo epidemi e përgjithshme si kolera e të ngjashme.."**. "Sherh Rijadis Salihin" (1/112)

**10. Nëse dikush sprovohet me këtë sëmundje dhe vdes duke duruar dhe shpresuar tek Allahu, i tilli shpresohet të arrijë gradën e dëshmorit.**

I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë në lidhje me murtajën: **"Nuk ka dikush që kur zbret murtaja qëndron në vendin e tij, duron, duke shpresuar në shpërblim, e di se nuk e godet asgjë vetëm se ajo që ka caktuar**

---

---

**Allahu për të, vetëm se për të tillin do të ketë shpërblim sikurse shpërblimi i dëshmorit (shehidit)".** Buhariu (3474)

Gjithashtu, në një tekst tjetër, i Dërguari i Allahut ﷺ thotë:

**"Murtaja është shehidllëk për çdo musliman".** Buhariu (2830) Muslimi (1916)

## **11. Udhëzimi profetik për parandalimin e epidemisë.**

Ky udhëzim është dy llojesh:

**Së pari:** marrja e shkaqeve konkrete për parandalimin e kësaj epidemie:

**a)** I Dërguari i Allahut ﷺ ka urdhëruar të mos hyjmë në një vend në të cilin ndodhen sëmundje të tilla, thotë ﷺ:

**"Nëse dëgjoni se murtaja ka rënë në ndonjë vend, mos shkoni aty. E nëse ju jeni në atë vend, atëherë mos dilni prej tij".** Buhariu (5728)

Kjo është masa parandaluese për të cilën porositi i Dërguari i Allahut para 14 shekujve, e që sot "mjekësia moderne" këtë e praktikon dhe rekomanon me rastin e koronavirusit!

**b)** I infektuari nga epidemia nuk duhet afruar të shëndetshmit, ashtu që të mos përhapet kjo sëmundje më tepër.

I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **"Mos të përzihet i sëmuri me të shëndetshmin".** Buhariu (5774)

Kjo gjithnjë duke u kujdesur në marrjen e shkaqeve parandaluese dhe kjo nuk bie në kundërshtim me atë se çdo gjë ndodh me caktimin e

---

---

Allahut sepse edhe kjo epidemi, ky virus, është shkak që e ka krijuar Allahu, i cili nuk mund t'i bëjë dëm askujt pa lejen e Tij.

**c)** Kujdesi për pastërtinë ndihmon në parandalimin e koronavirusit, sidomos pastrimi i duarve dhe hundës, e kjo realizohet më së miri përmes abdesit i cili merret së paku pesë herë në ditë.

I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "**Pastërtia është gjysma e besimit**". Muslimi (223)

Në një transmetim tjetër, thotë: "**Abdesi është gjysma e besimit**". Tirmidhiu (3517)

**Së dyti:** Kujdesi për kryerjen e adhurimeve dhe lutjeve profetike të cilat janë shkak për mbrojtje nga çdo e keqe, edhe nga koronavirusi me lejen e Allahut, prej tyre:

**a)** Kujdesi për namazin dhe falja e tij në kohë.

I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "**Kush e fal namazin e sabahut, ai është nën mbrojtje (sigurim) të Allahut**". Muslimi (657)

**b)** I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "**Kur dikush prej jush zbret apo hyn në një vend, le të thotë:**

«E'udhu bi kelimatil-lahit-tammati min sherri ma khaleka»

(Kërkoj mbrojtje me fjalët e përsosura të Allahut prej së keqes së çdo gjëje që Ai ka krijuar).

**Ngase, kush e thotë këtë lutje, nuk do ta dëmtojë atë asgjë derisa të largohet nga ai vend**". Muslimi (2708)

**c)** I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "**Kush e thotë këtë thënie (lutje):**

«Bismil-lahil-ledhi la jedurr-rru me'asmihi shej'un fil erdi ue la fis-semai ue hues-Semi'ul 'Alim» .

---

---

(Me emrin e Allahut, me përmendjen e të Cilit nuk mund të bëjë dëm asgjë në tokë dhe as në qiell. Allahu është Dëgjues, i Cili dëgjon çdo gjë dhe i Dijshëm për gjithçka!)

**Tri herë në mëngjes dhe tri herë në mbrëmje, atij nuk do t'i bëjë dëm asgjë".** Hadithi është i saktë.

**d)** Abdullah ibn Hubejb (Allahu qoftë i kënaqur me të) tha:

Më tha mua i Dërguari i Allahut ﷺ:

**"Lexo suren: «Kul huvAllahu ehad» dhe dy suret e fundit, Felek-un dhe Nas-in, në mbrëmje dhe në mëngjes, nga tri herë, të mjaftojnë për çdo gjë".** Hadithi është i saktë.

**e)** Leximi i ajetul kursisë (tesbih doves) në çdo kohë.

**h)** Leximi i dy ajeteve të fundit të sures Bekare. I Dërguari i Allahut thotë: **"Kush i lexon këto dy ajete gjatë natës do t'i mjaftojnë atij".** Buhariu (5009) dhe Muslimi (807)

Si dhe çfarëdo lutje tjetër që secili mund ta bëjë me përkushtim e përgjërëm tek Allahu i Lartësuar, në mënyrë që të na ruajë dhe ta largojë prej nesh këtë sprovë.

Allahu i Lartësuar thotë: **"Zoti juaj ka thënë: Lutmuni Mua që t'iu përgjigjem!"** (Gafir, 60)

Dhe thotë: **"O besimtarë! Kërkoni ndihmë për veten nëpërmjet durimit dhe namazit! Në të vërtetë, Allahu është me durimtarët".** (Bekare, 135)

**Së fundi**, lus Allahun e Lartësuar me Emrat e Tij të bukur dhe Cilësitë e Tij të larta: të na ruajë nga kjo epidemi, të largojë nga ne sprovat dhe

---

---

fatkeqësitë, të na shpëtojë ne, familjet tona, popullin tonë dhe gjithë muslimanët nga çdo e keqe. Amin!

Përgatiti

Agron Krasniqi

<http://t.me/hoxheAgronKrasniqi>